



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 136, datë 24.07.2019

**PËR
MIRATIMIN E AGJENTËVE NË SIGURIME, NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË
SHOQËRISË SË SIGURIMIT “SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të nenit 194, pika 4, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe të Rregullores nr. 79, datë 31.08.2015 “Për miratimin/licencimin e personave për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime si dhe rastet e mospranimit të regjistrimit të tij dhe refuzimit të licencës”, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Licencimin e subjektit “EASY PAY” sh.p.k., për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime, në klasat e Jo-Jetës, në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit “Sigal Uniqa Group Austria” sh.a.**
- 2. Miratimin e zj. Lindita Shomo dhe zj. Mariglana Kodra për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime, në klasat e Jo-Jetës, në emër dhe për llogari të subjektit “EASY PAY” sh.p.k.**
- 3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ANËTAR

Deniz DERALLA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin KOÇI